Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**14.04.2025**	**25.04.2025**	**2025/0260**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.04.2025, OE "Petrol Company - SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0260, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me lend djegese -Pelet" me nr. të prokurimit: "615-25-1234-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 315,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1.Neni 1 Qellimi
2.Neni 7 Barazia ne Trajtim Jo-Diskriminim
3.Neni 27 Dosja e Tenderit

4.Neni 28 Specifikimet Tenike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fakte për Ankimin:
Me daten 26.03.2025 kemi pranuar letren standarte sqarueses nga Komuna e Podujeves per te gjithe operatoret Ekonomike per karakteristikat e Peletit ngra druri i Ahut dhe avantazhi i tij, prandaj ne jemi kunder ketij sqarimi dhe kunder Autoriteti Kontraktues qe e kane perkufizuar kerkesen me vetem nje lloj te Peletit ku kemi parasysh se edhe llojet e Peleteve tjera i plotesojne keto karakteristika si Peleti i drurit te ahut.

Prandaj ne mendojme se jane bere keto shkelje si me poshte:

Diskriminimi i mundshëm i operatorëve ekonomikë: Kërkesa për përdorimin e vetëm peletit nga dru ahu mund të krijojë një barrierë për operatorët ekonomikë të tjerë, të cilët mund të ofrojnë peletë të cilësisë së lartë nga dru të tjera (p.sh., pisha, bredhi), të cilat janë gjithashtu të pajisura me standarde të njohura ndërkombëtare si ENplus A1 dhe që kanë performancë të ngjashme.

Parimi i konkurrencës së barabartë: Ligji për Prokurimin Publik i Kosovës, si dhe aktet e tjera përkatëse, përcaktojnë se tenderët duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kërkesa për të përdorur vetëm dru ahu mund të krijojë një paragjykim ndaj disa operatorëve, duke i kufizuar ata në ofrimin e një produkti që mund të jetë jashtë mundësive të tyre teknike apo financiare.

Kërkesa e paarsyeshme dhe e pajustifikueshme: Nuk ka asnjë arsyetim të qartë në dokumentet e tenderit përse është e domosdoshme që peleti të jetë vetëm nga dru ahu, ndërkohë që lloje të tjera të drurit gjithashtu ofrojnë një nivel të ngjashëm efikasiteti për ngrohje dhe mund të plotësojnë të gjitha kërkesat teknike të specifikuara.

Shkelja e parimit të transparencës: Një kërkesë e tillë mund të krijojë mungesë transparence dhe nuk ofron mundësi të barabarta për të gjitha palët, veçanërisht kur kriteret e dokumenteve të tenderit janë të formuluara në një mënyrë që favorizojnë disa operatorë dhe mund të kufizojnë mundësitë për konkurrencë të drejtë.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, neni 6 mbi parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, çdo procedurë prokurimi duhet të përmbajë kritere të qarta që sigurojnë konkurrencë të drejtë dhe kualifikim të duhur të ofertuesve.

Në këtë rast, kemi vërejtur se dokumentacioni i tenderit nuk përmban asnjë kriter adekuat që lidhet me mundësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, që zakonisht janë thelbësore për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës.

Mungesa e kritereve të qarta teknike dhe profesionale mundëson pjesëmarrjen e operatorëve pa eksperiencë dhe kapacitete të duhura, gjë që rrit rrezikun për furnizime me cilësi të ulët ose mospërmbushje të kontratës.
Mundësia e keqpërdorimit - Kjo mungesë e kritereve lejon interpretim subjektiv nga autoriteti kontraktues në vlerësimin e ofertave, duke rritur rrezikun e parregullsive ose favorizimeve.
Përputhja me praktikat e mira të prokurimit - Në shumicën e tenderëve për produkte të ngjashme (si furnizimi me pelet), zakonisht përshihen kritere të qarta mbi:
Kapacitetin teknik (certifikatat e cilësisë si ENplus A1/A2)
Kapacitetin logjistik (magazinim dhe transport adekuat)

Kërkesat tona
Duke u bazuar në argumentet e sipër, kërkojmë që autoriteti kontraktues:
kërkojmë që të rishikohet kërkesa për përdorimin e vetëm peletit nga dru ahu dhe të mundësohet një mundësi për të ofruar alternativa, duke marrë parasysh edhe peletët e drurit të butë dhe të tjera lëndë të drurit, të cilat janë të pranueshme sipas standardeve ndërkombëtare.
Të rishikojë dhe të plotësojë dosjen e tenderit duke përfshirë kritere adekuate mbi mundësitë teknike dhe profesionale.
Të sigurojë transparencë dhe trajtim të barabartë të ofertuesve, duke u bazuar në standardet e prokurimit publik.
Të japë një përgjigje zyrtare lidhur me këtë ankesë brenda afateve ligjore

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. **Humbja e mundësive të fitimit**
2. **Dëmtimi i reputacionit**
3. **Rreziku i humbjes së besimit nga klientët dhe partnerët**

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

NR. I ART.	PËRSHKRIMI
1	**Pelet për ndezje -ngrohje.të klasit të parë (peleti duhet të jet nga druri ahu 100%)**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Petrol Company - SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratësfurnizim kontratë publike kornizë. Vlera e parashikuar 315,000.00 €, ku për vitin 2025 është parashikuar vlera 95,000.00, për vitin 2026 është parashikuar vlera 110,000.00 dhe për vitin 2027 është parashikuar vlera 110,000.00 euro. Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët".**

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27 dhe 28 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kritereve). Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigjet si në vijim.

OE ankues potencon se me datën 26.03.2025 kanë pranuar letrën standarde sqaruese nga AK për të gjithë operatoret ekonomik për karakteristikat e Peletit nga druri i Ahut dhe avantazhi i tij, kurse OE ankues Petrol Company SH.P.K, është kundër këtij sqarimi dhe kërkesës së AK që kanë përkufizuar kërkesën vetëm me një lloj Peleti, ku kemi parasysh edhe llojet e peleteve tjera që i plotësojnë këto karakteristika, si Peleti i drurit të ahut.

Tutje OE ankues potencon se kërkesa për përdorimin e vetëm peletit nga dru ahu mund të krijojë një barrierë për operatorët ekonomik të tjerë të cilët mund të ofertojnë peletë të cilësisë së lartë nga dru të tjerë (p.sh pisha, bredhi) të cilët janë gjithashtu të pajisura me standarde të njohura ndërkombëtarë si ENplus A1 dhe që kanë përformancë të ngjashme.

Parimi i konkurrencës si dhe aktet tjera përkatëse të LPP-së përcaktojnë se tenderët duhet

sigurojnë mundësi të barabartë për te gjithë OE-të, kërkesa për përdorim vetëm dru ahu mund të krijojë një paragjykim ndaj disa operatorëve ekonomik, duke kufizuar atë në ofrimin e një produkti që mund të jetë jashtë mundësive të tyre teknike apo financiare. Kërkesat e paarsyeshme dhe të pa justifikushme përse është e domosdoshme që peleti te jetë vetëm nga dru ahu ndërkohë që llojet tjera të drurit ofrojnë një nivel të ngjashme efikasiteti për ngrohje dhe mund të plotësojnë të gjitha kërkesat teknike të specifikuara.

Po ashtu në ankesë, OE ankues potencon se në dosjen e tenderit nuk përmban asnjë kriter adekuat që lidhet me mundësitë teknike profesionale të operatorëve ekonomik që janë thelbësorë për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës. Në shumicën e tenderëve për produkte të ngjashme (si furnizime me pelet) zakonisht përfshihen kritere të qarta mbi:

Kapacitetin teknik (certifikatat e cilësisë si ENplus A1/A2)

Kapacitetin logjistik (magazinim dhe transport adekuat)

Përgjigje në pretendimin ankimor: Pretendimet kryesore ankimore ka të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kritereve), konkretisht kundër kërkesës tek Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme ku është kërkuar: **"Pelet për ndezje -ngrohje,të klasit të parë (peleti duhet të jet nga druri ahu 100%)"** Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK-Komuna e Podujevës, ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 27.02.2025, tek pika 16.1 e dosjes së tenderit, AK ka përcaktuar datën për sqarimin e tenderit deri me 17.03.2025.Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës me datën 26.03.2025 përmes Letrës standarde për sqarimin e tenderit për operatoret ekonomik ka dhen sqarim si në vijim:

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit për OE

26.03.2025

Komuna e Podujevës

Nr. i prokurimit:	**615**	**2**	**51**	**2**	**3**	**4**	**1**	**1**	**1**

Titulli:
Furnizim me lënd djegëse -Pelet
Duke marr parasysh se Peleti i përbërë 100% nga druri i ahut ka disa avantazhe të rëndësishme:

1. Efikasitet i lartë i djegies – Ahu ka një përmbajtje të ulët lagështie dhe një vlerë të lartë kalorifike, duke siguruar më shumë energji për kilogram të djegur.

2. Më pak hiri – Krahasuar me llojet e tjera të drurit, peleti nga ahu prodhon më pak mbetje hiri, duke reduktuar nevojën për mirëmbajtje të shpeshtë të sobave dhe kaldajave.

3. Djegie e pastër – Peleti nga ahu djegët me më pak tym dhe emeton më pak substanca ndotëse në ajër, duke qenë më miqësor me mjedisin.

4. Aromë e këndshme dhe e natyrshme – Ahu lëshon një aromë të butë druri gjatë djegies, e cila është e këndshme dhe jo irrituese.

5. Dendësi e lartë dhe strukturë kompakte – Kjo bën që peleti të ketë një djegie të qëndrueshme dhe uniforme, duke e bërë më efikas për sistemet e ngrohjes.

6. Pa aditivë kimikë – Nëse është i prodhuar në mënyrë natyrale, peleti nga ahu nuk përmban ngjitës ose kimikate të dëmshme, duke qenë më i shëndetshëm për përdorim.

7. Disponueshmëri dhe qëndrueshmëri – Ahu është një dru i fortë dhe i qëndrueshëm, prandaj peleti i tij ka jetëgjatësi më të madhe gjatë magazinimit dhe nuk prishet lehtë.

duke i marr parasysh te gjitha keto veti e po ashtu ajo qe eshte me rendesi se kjo kerkese e jona per furnizim me pelet te ketij lloji nuk e perjashton kompanit konkurruese te marrin pjese me ofertat e tyre per ofrimin e llojit te tille te peletit.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Ndërsa tek Dosja e tenderit te Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme ka kërkuar:

Aneksi 1 **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

NR. I ART.	PËRSHKRIMI
1	Pelet për ndezje -ngrohje.të klasit të parë (peleti duhet të jet nga druri ahu 100%)

Sa i përketpretendimi ankimor të OE ankues në lidhje me ndryshim e kësaj kërkese siç është cekur më lartë, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se AK me datën 26.03.2025, përmes Letrës standarde për sqarimin e tenderit për operatoret ekonomik ka dhëne sqarime të hollësishme pse peleti i përbërë 100% nga druri i ahut ka avantazhe të rëndësishme. Po ashtu, bazuar në natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, konsideroj se kjo kërkesë e AK-së, nuk e redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik apo diskriminoj në dëm ose në të mirë të një apo më shumë operatorëve ekonomik sipas nenit 6 dhe 7 të LPP-së, por është kërkesë e cila siguron autoritetin kontraktues lidhur me furnizimin më cilësor sepse avantazhet e produktit të peletit nga druri i ahut 100% ka cilësi më të mirë, pra ka fuqi djegëse më shumë apo është më kalorik, ku AK konsideron dhe ka vlerësuar se ky lloj ka efikasitet më të lartë për autoritetit kontraktues dhe atyre institucioneve, të cilat përfitojnë nga ngrohja me pelet. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se në dosjen e tenderit nuk përmban asnjë kriter adekuat që lidhet me mundësitë teknike profesionale të operatorëve ekonomik, që janë thelbësorë për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës.

Përgjigje në pretendimin ankimor: Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë konsideron se AK do duhet të tek kërkesat të kërkoj dëshmi dokumentare në lidhje me përmbajtjen e produktit përmes ndonjë certifikate apo deklaratës së prodhuesit, ku përfshihet përmbajtja apo përbërësit e produktit të peletit, ashtu siç ka kërkuar AK "pelet nga druri i Ahu-t 100%". Gjithashtu, AK do duhet që në dosje të tenderit të specifikojë mënyrën e transportit apo bartjes. Në rast se AK kërkon nga OE i shpallur fitues që të bëjë transportin, atëherë AK duhet të saktësojë adresën apo lokacionet se ku do të bëhet pranim dorëzimi. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Petrol Company - SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli